



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 203 Prot.

Tiranë, më 08.03 2016

VENDIM Nr. 3, datë 29.02.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 42, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.2, të datës 29.02.2016, pasi shqyrtoi projektin "Konservim -Restaurim i mureve në Butrint, pjesa e murit të Akropolit dhe muri në afërsi të Portës së Liqenit, Butrint", paraqitur nga Instituti i Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

- I. Të kryhet nga Instituti i Arkeologjisë në bashkëpunim me Parkun e Butrintit një sondazh arkeologjik, për testimin e formacionit të dherave prapa mureve antike, për përcaktimin e thellësisë së dherave të hedhura që duhen hequr, për lehtësimin e strukturës së këtyre mureve nga presioni i tyre.
- II. Gërmimi i dherave të hedhura, pas përcaktimit të thellësisë së tyre, në funksion të projektit të sipërpërmendur, të realizohet nga specialistë të fushës së arkeologjisë, nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të Parkut të Butrintit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO